VENDIM
Nr. 186, datë 25.11.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E "DRAFTMETODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË TARIFËS SË SHITJES SË GAZIT NATYROR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT"

Në mbështetje të nenit 90, pika 11, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; të neneve 19 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 111/6 prot., datë 22.11.2019, të Drejtorisë së Tarifave dhe të Çmimeve, mbi miratimin e "Draftmetodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit",

konstatoi se:

-Në mbështetje të nenit 90, pika 11, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, ERE miraton metodologjinë për përcaktimin e tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

-Kjo metodologji shërben për përcaktimin e tarifës së shitjes së gazit natyror të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, bazuar në parime të qarta të tarifimit dhe detajimin e të dhënave të nevojshme për përcaktimin e tarifave sa më të drejta dhe transparente në këtë fushë të rëndësishme.

-Kjo metodologji do të gjejë zbatim vetëm mbi të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit e furnizuesit të mundësisë së fundit në sektorin e gazit natyror, të caktuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e "Draftmetodologjisë së përcaktimit të tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit".

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT TË ERE-s
Erjola Sadushi